



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.40/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Delushe Halimi dhe Beshir Islami, anëtar, në çështjen disiplinore, ndaj G.N., Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren -Departamenti i Krimeve të Rënda dhe M.G., Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur në procedurën e ankesës kundër vendimit të KPK/Nr.1034/2024, të datës 07 tetor 2024, në seancën të kolegjit të mbajtur më datë 20.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET si e bazuar ankesa e paraqitur nga M.G., prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, PRISHET vendimi i Këshilli Prokurorial të Kosovës në Prishtinë, KPK/Nr.1034/2024, i datës 07.10.2024, në pikën I, II dhe IV, sa i përket masës disiplinore të shqiptuar ndaj prokurorit M.G., dhe lënda i kthehet Këshillit Prokurorial të Kosovës në Prishtinë, për rishqyrtim.

II. Pjesa tjetër e vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës në Prishtinë, KPK/Nr.1034/2024, i datës 07.10.2024, sa i përket masës disiplinore të shqiptuar ndaj Prokurorit G.N., prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, mbetet e pa shqyrtuar.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës në Prishtinë, (në tekstin në vazhdim Këshilli), me vendimin KPK/Nr.1034/2024, të datës 07 tetor 2024, ka vendosur: I. Aprovohet si i bazuar Raporti i Panelit Hetimor AD.nr.6/2024, i datës 27 shtator 2024, në rastin disiplinor ndaj Prokurorit G.N., Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda dhe Prokurorit M.G., Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm. II. Vërtetohet se te Prokurorët G.N., dhe M.G., janë gjetur elemente të përgjegjësisë disiplinore, në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, pika 1.3

dhe neni 6, paragrafi 2, pika 2.10 të Ligjit Nr. 06/1-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë. III. Prokurorit G.N., i shqiptohet sanksioni disiplinor “Vërejtje publike me shkrim”, në përputhje me nenin 7 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit Nr. 06/L057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. IV. Prokurorit M.G., i shqiptohet sanksioni disiplinor “Zvogëlim i përkohshëm i pagës tridhjetë (30%) për një periudhë kohore tre (3) muaj”, në përputhje me nenin 7 paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kundër këtij vendimi prokurori M.G., në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar vendimin e goditur për shkak të shkeljeve procedurale të përcaktuara me Rregulloren nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, si dhe Ligjit nr.06/L0057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, ankesën e subjektit hetimor (Prokurorit të shtetit M. G.), ta aprovojë si të bazuar dhe vendimin e Këshillit, KPK.nr.1034/2024 të datës 07.10.2024, ta ndryshojë, duke e liruar nga përgjegjësia disiplinore.

Me përgjigje në ankesë KPK, ka propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës, ta refuzoj ankesën AA.40/2024 dhe ta vërtetojë vendimin e Këshillit KPK/Nr.1034/2024, të datës 07 tetor 2024.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka gjetur se:

Ankesa e prokurorit M.G., është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Këshilli, më datë 17 korrik 2024, nga Autoriteti Kompetent, ish Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, z. Admir Shala, ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj Prokurorit M.G., Departamenti i Përgjithshëm, në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe Prokurorit G.N., Departamenti i Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prizren. Më datë 09 korrik 2024, “Betimi për Drejtësi” kishte zhvilluar një hulumtim lidhur me konsumimin e pijeve alkoolike brenda orarit zyrtar nga zyrtarët e sistemit të drejtësisë në Prizren. Gjatë këtij hulumtimi kishin hasur në prokurorët G.N. dhe M.G., të cilët në kohën e pauzës, derisa kanë qenë në lokalin tek “Zh.”, afër objektit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren, kanë konsumuar pije alkoolike “birrë” dhe në shoqëri të tyre në tavolinë kanë qenë gjyqtari G.K., Gjykata Themelore në Prizren dhe personi i quajtur R.T., i cili kishte qenë palë (i akuzuar), në një lëndë tek prokurori M.G., ku ishin inçizuar fshehurazi nga kameramani i “Betimit për Drejtësi”.

Autoriteti Kompetent i ka rekomanduar Këshillit, që ndaj prokurorëve të lartcekur, të shqiptohet sanksioni disiplinor “Vërejtje publike me shkrim”, konform nenit 7, paragrafi 1, pika 1.2, si dhe për shkak të shkeljes së nenit 6, paragrafi 1, pika 1.3 dhe paragrafi 2,

pika 2.10 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Më datë 01 gusht 2024, Këshilli, ka nxjerr vendim me numër KPK/Nr.830/2024, për Themelimin e Panelit Hetimor për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.6/2024, ndaj Prokurorëve G.N., Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda dhe M.G., Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm.

Më datë 01 tetor 2024, Këshilli, nga Paneli Hetimor, ka pranuar Raportin AD.nr.6/2024, me të cilin ka ardhur në përfundim se, Prokurorët G.N. dhe M.G., kanë vepruar në shkelje të nenit 6, paragrafi 2, pika 2.10 të Ligjit Nr.06/L057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve.

Në arsyetim të vendimit të atakuar, Këshilli ka theksuar se: pas dëgjimit të Kryesuesit të Panelit Hetimor, subjekteve të hetimit disiplinor, shqyrtimit dhe analizimit, të provave të cekura në Raportin e Panelit, fjalës përfundimtare të kryesuesit të Panelit Hetimor dhe prokurorëve G.N. dhe M.G., erdhi në përfundim se në rastin AD.nr. 6/2024, është vërtetuar shkelja disiplinore si në dispozitiv të këtij vendimi pasi që nga provat e grumbulluara dhe deklaratat e subjekteve të hetimit disiplinor, nuk është kontestuar fakti se prokurori M.G., ditën kritike është ulur në tavolinë me ish të akuzuarin, edhe përkundër se i njëjti e ka mohuar një gjë të tillë, pasi që Prokurori N., e kishte ftuar të ulet në tavolinë me të, ish i akuzuar ndaj të cilit prokurori G., kishte ngritur aktakuzë dhe i njëjti (R.T.) me aktgjykim, ishte shpallur fajtor, për veprë penale “Lëndim i rëndë trupor”, nga neni 186, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të KPRK-së. Nuk mund të arsyetohet me faktin se i njëjti ka qëndruar një kohë të shkurtër në tavolinë me ish të akuzuarin dhe prokurorin G.N., e që ka qenë në dijeni ose është dashur të jetë në dijeni se, nuk mund të qëndroj në të njëjtën tavolinë, duke ngrënë dhe konsumuar birra (pije alkoolike), me ish të akuzuarin, të cilat veprime vërtetohen edhe përmes videoinçizimit, deklaratave të të dy prokurorëve - subjekt të hetimit disiplinor dhe nga provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës. Po ashtu, nga deklarata e subjektit të hetimit disiplinor G.N., nuk është kontestuar fakti se gjatë orarit të pauzës, ka qenë duke konsumuar alkool me të akuzuarin - dënuarin, përkundër se i njëjti e ka mohuar se konsumimi i alkoolit gjatë kohës së pauzës të konsiderohet orar i punës, edhe pse me përvojë tridhjetë e katër (34) vjeçare, si prokurorë nuk e ka ditur se konsumimi i një birre me të akuzuarin-dënuarin mund të jetë shkelje disiplinore.

Ka shtuar se lidhur me pohimet e Prokurorit M.G. se, në rastin të cilin e ka pasur më parë në Këshillin Prokurorial të Kosovës, ku i është shqiptuar “Vërejtje publike me shkrim”, Gjykata e Apelit ka marr vendim ku është prishur kualifikimi, një gjë e tillë nuk mund të arsyetohet, pasi që vendimi i Gjykatës së Apelit, ka të bëjë me çështjen penale, ndërsa Këshilli ka vendosur për çështjen disiplinore të të njëjtit, ku Gjykata Supreme e Kosovës e ka refuzuar ankesën e prokurorit G. si të pathermeltë. Ndërsa, sa i përket propozimit të prokurorit M.G. për ti dëgjuar dëshmitarët, të cilët ditën kritike

kanë qenë prezent në lokalin ku ka ndodhur incidenti, Paneli Hetimor e ka vlerësuar se dëshmitarët e ftuar nga prokurori G., nuk kanë qenë të nevojshëm sepse nga videoinçizimi, aktakuza, aktgjykimi i gjykatës ndaj ish të akuzuarit R.T., dhe deklaratat e të dy prokurorëve N. dhe G., është vërtetuar drejtë gjendja faktike se, prokurori N. dhe G., janë shoqëruar me ish të akuzuarin dhe të njëjtit kanë konsumuar “Birra” gjatë orarit të punës, ku kanë vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi që i përkasin 1, pika 1.3 dhe nenit 6, paragrafi 2, pika 2.10 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve.

Andaj, Këshilli pas dëgjimit të kryesuesit të Panelit Hetimor, fjalës përfundimtare të tij, dëgjimit dhe fjalës përfundimtare të subjekteve të hetimit disiplinor, me shumicë të votave erdhi në përfundim se, në rastin konkret AD.nr.6/2024, për prokurorin G.N., është vërtetuar së në rastin konkret ka shkelje disiplinore dhe është shqiptuar sanksioni disiplinor “Vërejtje publike me shkrim”, ndërsa për prokurorin M.G., është vërtetuar se ka shkelje disiplinore dhe është shqiptuar sanksioni disiplinor “Zvogëlim i përkohshëm i pagës tridhjetë (30%), për një periudhë kohore tre (3) muaj”, të cilat sanksione janë në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e Panelit Hetimor. Serioziteti i shkeljes disiplinore i kryer nga Prokurori G.N. dhe M.G., pasojat e shkeljes disiplinore, rrethanat në të cilat është kryer shkelja, sjellja e përgjithshme e subjekteve të hetimit disiplinor, si dhe sjellja dhe bashkëpunimi në procedurë disiplinore, sanksionet disiplinore “Vërejtje publike me shkrim”, ndaj prokurorit G.N., si dhe “Zvogëlim i përkohshëm i pagës tridhjetë (30%), për një periudhë kohore tre (3) muaj”, për prokurorin M.G. dhe “Vërejtja publike me shkrim”, e më hershme e shqiptuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës ndaj prokurorit M.G., me vendimin KPK/Nr.510/2022, të datës 14 prill 2022, janë rrethana këto që kanë ndikuar në gjetjen e nivelit të proporcionalitetit në mes të shkeljes disiplinore dhe sanksionit disiplinor.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të Këshillit, si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate vendimi i Këshillit, është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit nr.06/L0057, për Përgjegjësit Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Rregullores nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve dhe zbatim të gabuar të ligjit dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht, e që ndikon në paanësinë dhe integritetin e procedurës disiplinore, për të cilin shkak vendimi i Këshillit, është dashur të priset.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, vendimi i Këshillit, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i vendimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e Këshillit. Këshilli nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre

janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi për shqiptimin e sanksionit disiplinor “Zvogëlim i përkohshëm i pagës tridhjetë (30%) për një periudhë kohore tre (3) muaj”, ndaj prokurorit M.G.. Këshilli i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e Këshillit, e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi shkeljen e pretenduar disiplinore, përgjegjësin dhe sanksionin disiplinor.

Pra kjo gjykatë vlerëson se Këshilli, në vendimin e tij nuk ka dhënë arsye në lidhje me pretendimet thelbësore të ngritura nga subjekti i hetimit disiplinor, e që kanë të bëjnë me çështjen e shkeljes së pretenduar disiplinore, përgjegjësisë dhe sanksionit disiplinor. Po ashtu në vendimin e atakuar nuk ka asnjë arsye në lidhje me çështjet e ngritura nga subjekti i hetimit disiplinor, as në aspektin e shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit të cituar, si dhe as në aspektin e aplikimit të gabuar të ligjit.

Sipas kësaj gjykate, nuk mjafton që Këshilli, vetëm të konstatoj se ekzistojnë shkelja disiplinore, por është obligim që të paraqes arsye të qarta në lidhje me atë se a ekziston apo jo shkelja e pretenduar, pastaj cilat janë veprimet e subjektit të hetimit disiplinor, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e prokurorit të shtetit ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e prokurorit të shtetit, si dhe përgjegjësisë dhe sanksionin disiplinorë. Në këtë kontekst duhet pasur parasysh se e drejta për të pasur një vendim të arsyetuar është pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Këshilli, në vendimin e tij ka konstatuar se subjekti i hetimit disiplinor, prokurori M. G., ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 pika 1.3 dhe paragrafi 2 pika 2.10, të Ligjit nr.06/L-057, për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve, mirëpo në arsyetim të vendimit nuk ka sqaruar në mënyrë të qartë dhe bindëse se me cilat veprime i njëjti ka ra në kundërshtim me këto dispozita ligjore.

Këshilli, në arsyetim të vendimit është mjaftuar vetëm me faktin se “prokurori M.G., ditën kritike është ulur në tavolinë me ish të akuzuarin, pasi që Prokurori N., e kishte ftuar të ulet në tavolinë me të, ish i akuzuar ndaj të cilit prokurori G., kishte ngritur aktakuzë dhe i njëjti (R.T.) me aktgjykim, ishte shpallur fajtor, për veprë penale “Lëndim i rëndë trupor”, nga neni 186, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të KPRK-së, e që ka qenë në dijeni ose është dashur të jetë në dijeni se, nuk mund të qëndroj në të njëjtën tavolinë, duke ngrënë dhe konsumuar birra (pije alkoolike), me ish të akuzuarin, të cilat veprime vërtetohen edhe përmes videoinçizimit, deklaratave të të dy prokurorëve - subjekt të hetimit disiplinor dhe nga provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës”. Gjithashtu ka konstatuar se ka qëndruar duke ngrënë dhe duke konsumuar birra (pije alkoolike) me të akuzuarin - dënuarin është shkelje disiplinore.

Nga konstatimi i lartcekur nga ana e Këshillit, kjo gjykatë vlerëson se nuk është vërtetuar drejtë dhe saktë gjendja faktike. Këshilli, nuk ka arritur të vërtetoj faktin nëse prokurori M.G., ditën kritike ka qenë në tavolinë së bashku me ish të akuzuarin (R.T.) dhe prokurorin G.N., duke ngrënë ushqim dhe duke konsumuar birra (pije alkoolike), nuk ka arritur të vërtetoj faktin se nëse prokurori në fjalë, ka shkuar në tavolinën e prokurorit G.N., me rastin e ndodhjes së incidentit të ndodhur në të njëjtin lokal ku është sulmuar një gazetar, apo takimi i tyre ka qenë i planifikuar paraprakisht, nuk ka arritur të vërtetoj faktin se nëse prokurori në fjalë ka konsumuar birrë apo birra, nuk ka sqaruar se a mund të konsiderohet konsumimi i vetëm një birrë gjatë ushqimit arsye për shqiptimin e masës disiplinore, nuk e ka vërtetuar faktin nëse i njëjti ka konsumuar ushqim së bashku me prokurorin dhe ish të akuzuarin, apo është gjendur aty në mënyrë rastësore, nuk ka sqaruar faktin se a mund të konsiderohet arsye për shqiptimin e masës disiplinore qëndrimi i rastësishëm dhe i shkurt me ish të akuzuarin i cili është dënuar për veprën për të cilën është akuzuar, si dhe nuk është marrë parasysh fakti se prokurori menjëherë pas ngjarjes ka raportuar situatën tek personat kompetent.

Po ashtu Këshilli, nuk ka marrë parasysh fare propozimin e prokurorit M.G., për dëgjimin e dëshmitarëve në mënyrë që të qartësohet saktë nëse pretendimet e prokurorit janë të vërteta. Me dëgjimin e dëshmitarëve do të vërtetohej fakti, nëse prokurori M. G. është gjendur rastësisht në tavolinën e ftuar nga Prokurori G.N., apo kanë qenë së bashku gjatë tërë kohës, gjithashtu do të vërtetohet fakti nëse i njëjti ka konsumuar birrë/birra, nëse i njëjti ka konsumuar ushqim së bashku me prokurorin dhe ish të akuzuarin (R. T.), do të vërtetohej fakti se për sa kohë ka qëndruar i njëjti në tavolinë dhe pas vërtetimit të këtyre fakteve Këshilli, do të kishte një pasqyrë të qartë dhe të saktë për veprimet e prokurorit M.G., dhe pastaj do të konstatonte nëse i njëjti ka bërë shkelje të Ligjit nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve.

Përveç të cekurave nëse i referohemi arsyetimit të vendimit të cituar, nuk mund të kuptohet se subjektit të hetimit në këtë rast a ju ka shqiptuar sanksioni disiplinor për shkak se ka qëndruar në të njëjtën tavolinë me ish të akuzuarin, apo për faktin se ka qëndruar duke ngrënë dhe konsumuar birra (pije alkoolike), por ka mjaftuar duke cituar dispozitat e ligjit të cituar.

Këshilli, në rishqyrtim, udhëzohet që ti evitohet shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të Ligjit nr.06/L0057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të Rregullores nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve, në atë mënyrë që të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj këshilli do të ndërmerri hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që

në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur propozimin për shqiptimin e masës disiplinore dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitat e lartcekura.

Nga arsyet e cekura Gjykata Supreme e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e duke u mbështetur në nenin 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

A.A.nr.40/2024, më datë 20.11.2024.

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi, d.v